



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 11.05.2021, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Alket Hyseni – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rregullores së brendshme dhe funksionimi i veprimtarisë së Komisionit Hetimor
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të Komisionit Hetimor
3. Caktimi i ekspertëve për marrjen e ekspertizave, që kërkojnë njohuri të posaçme, sipas objektit të hetimit.
4. Çështje të tjera.

**Marrin pjesë:**

Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka dhe Arlind Çaçani.

## HAPET MBLEDHJA

**Alket Hyseni** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Hetimor për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e komisionit.

Mbledhja është e vlefshme.

Rendi i ditës së mbledhjes së sotme përmban këto çështje:

Miratimi i rregullores së brendshme dhe funksionimi i veprimtarisë së Komisionit Hetimor.

Miratimi i kalendarit të punimeve të Komisionit Hetimor.

Caktimi i ekspertëve për marrjen e ekspertizave, që kërkojnë njohuri të posaçme, sipas objektit të hetimit.

Çështje të tjera.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, dua të informoj anëtarët e komisionit, por edhe opinionin publik se në zbatim të planit paraprak të hetimit, si dhe të kërkesave të parashtruara nga anëtarët e komisionit në mbledhjen konstituente të këtij komisioni, në emër të Kuvendit dhe të Komisionit Hetimor, janë dërguar shkresat e mëposhtme:

1. Njoftimi i Presidentit të Republikës për ngritjen e Komisionit Hetimor, objekti i hetimit dhe e drejta e Presidentit për t'u shprehur në këtë komision, sipas parashikimeve të Kushtetutës, të Rregullores së Kuvendit dhe të ligjit "Për funksionimin e komisioneve hetimore.

2. Kërkesa drejtuar Presidentit të Republikës për ndarjen e titujve dhe aktiviteteve protokollare të Presidentit dhe zyrës së Presidentit gjatë fushatës elektorale.

3. Kërkesa drejtuar Autoritetit të Medieve Audiovizive për të vënë në dispozicion deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës në mediet e shkruara dhe kasetat filmike të mesazheve apo deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës në këto medie audiovizive për sa i takon objektit të hetimit të këtij komisioni, edhe sipas përkatësisë së lidhjes 1 dhe 2 të kërkesës së bërë nga një grup prej 49 deputetësh të Kuvendit.

4. Kërkesa drejtuar Bashkisë së Tiranës për të vënë në dispozicion informacionin për procedurat e kryera nga Bashkia e Tiranës gjatë ekzekutimit të lirimit të mjediseve të zyrave të Partisë "Fryma e Re Demokratike", aktet përkatëse dhe informacionin për ndërhyrjet dhe veprimet e kryera nga Presidenti i Republikës për të njëjtën çështje.

5. Kërkesa drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të vënë në dispozicion çdo lloj informacioni, që disponohet për objektin e hetimit të komisionit, duke

përfshirë sinjalizime për planifikime trazirash politike, për takime të Presidentit të Republikës me persona të ndryshëm gjatë periudhës së objektit të hetimit, komunikatat zyrtare të Policisë së Shtetit gjatë periudhës zgjedhore, si dhe çdo informacion tjetër, që disponohet nga Policia e Shtetit, për sa i takon drejtpërdrejt apo indirekt objektit të hetimit të këtij komisioni.

6. Kërkesa drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të vënë në dispozicion një informacion nëse ka vepra penale apo kallëzime të regjistruara, të lidhura me zgjedhjet për periudhën e fushatës zgjedhore të vitit 2021, si dhe çdo lloj informacioni, që disponohet për objektin e hetimit të këtij komisioni nga këto prokurori.

7. Kërkesa drejtuar Shërbimit Informativ të Shtetit për të vënë në dispozicion çdo lloj informacioni, që disponohet për objektin e hetimit të komisionit, duke përfshirë takime të ndryshme të Presidentit të Republikës, sinjalizime për planifikime trazirash politike gjatë periudhës së hetimit, si dhe çdo informacion tjetër që disponohet për sa u përket veprimeve, deklarimeve apo mosveprimeve të Presidentit të Republikës, që mund të jenë objekt hetimi i këtij komisioni.

Të nderuar anëtarë, këto ishin detyrat që ne caktuam në mbledhjen e kaluar, të cilat janë kryer nga administrata deri më sot.

Fillojmë me rendin e ditës.

Secili ka përpara draftrregulloren e funksionimit të veprimtarisë së Kuvendit. Besoj se jeni njohur me të.

A keni komente apo sugjerime?

Ndjesë, para se të jemi dakord me rendin e ditës, mund ta shprehim me votim, ju lutem?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

A keni sugjerime apo do të kalojmë direkt në miratim?

Rregullorja, me të cilën ky komision do të orientojë punën, është formale dhe e bazuar tërësisht në Rregulloren e Kuvendit, në ligjin “Për komisionet hetimore”, si dhe në përcaktimet kushtetuese për rastin.

Ta hedhim në votim rregulloren.

Kush është dakord me rregulloren e brendshme të paraqitur si draft?

Të gjithë dakord.

Miratohet rregullorja e brendshme e funksionimit të Komisionit Hetimor.

Hapet diskutimi për kalendarin e punimeve të Komisionit Hetimor.

A ka nevojë ta lexoj? Apo ta lexoj për efekt të opinionit publik?

Pra, kemi mbledhjen e sotme, datë 11 maj, me rendin e ditës që unë lexova, për të mos e përsëritur; kemi parashikuar një mbledhje në datën 14 maj 2021, miratimi i planit përfundimtar të hetimit dhe çështje të tjera; një mbledhje e planifikuar për në datën 17 maj: administrimi dhe shqyrtimi informacioneve të dhëna, raporteve të marra nga institucioni për objektin e hetimit dhe çështjeve të tjera. Besoj se deri në fund të kësaj jave, apo në fillim të javës tjetër, do të kenë ardhur të gjitha informacionet e kërkuara nga institucionet dhe do të jemi në gjendje t'i përmbahemi kalendarit.

Ditën e martë, më 18 maj, kemi parashikuar seancë dëgjimore me Presidentit e Republikës, duke pasur parasysh se presim një përgjigje, nëse Presidenti do të ushtrojë të drejtën e tij për t'u dëgjuar, ose do të shikojmë vendimin e këtij komisioni nëse Presidenti nuk do të dëshirojë të shprehet dhe nëse ky komision do të vlerësojë nëse do të thirret apo jo, pavarësisht kërkesës së Presidentit, datë e cila mund të jetë fleksibël, nëse biem dakord, që të diskutohet edhe me zyrën e Presidentit, apo ndoshta për një datë tjetër. Duke pasur parasysh afatin e kufizuar të veprimtarisë së këtij komisioni, fleksibiliteti do të jetë i kufizuar, duke diskutuar vetëm brenda javës që vjen.

Në datën 20 maj është shqyrtimi përfundimtar dhe nxjerrja e konkluzioneve të hetimit për t'i dhënë disa ditë kohë shkrimit të raportit të këtij komisioni, duke gjykuar se në datën 24 maj mund të jemi gati për prezantimin e raportit final të këtij komisioni.

Duhet të kemi parasysh se jemi brenda afatit të caktuar me ndihmën e komisionit, por, gjithashtu, duhet të marrim parasysh që edhe Kuvendit do t'i duhet një afat i caktuar, i përcaktuar edhe në Rregullore. Në mos gaboj, brenda 20 ditëve Kuvendi duhet të marrë në shqyrtim raportin, për të vijuar më tej me procedurën përkatëse të shkarkimit të Presidentit.

A keni sugjerime për kalendarin?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, data 14 maj: Miratimi i planit përfundimtar të hetimit dhe çështje të tjera.

Data 17 maj: Administrimi i të gjithë informacionit, shkresave të institucioneve dhe raporteve të ndryshme për objektin e hetimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E morëm vendimin.

Institucionet kanë afat deri në fund të javës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, janë njoftuar institucionet.

Gjithsesi, ju thashë se nëse ka ndonjë situatë, ne këtu jemi, nuk ka asgjë të padiskutueshme.

Data 18 maj: Seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës.

Data 20 maj: Shqyrtimi përfundimtar dhe nxjerrja e konkluzioneve të hetimit.

Duhet të jemi të qartë se ne e kemi shumicën e materialeve, por kërkojmë të marrim anën zyrtare të këtyre materialeve. Pra, janë paraqitur nga një grup deputetësh, por ne nuk mund të mjaftohemi, si një komision i pavarur, dhe do të presim të vijmë edhe në anë zyrtare.

Do të marrim informacione nga institucionet, do të bëjmë dëgjësë me Presidentin e Republikës. Besoj se kjo është një panoramë e plotë për çfarë mund të bëjmë ne, si Komision Hetimor për të arritur një konkluzion.

Pas datës 20 do t'i japim 4 ditë kohë shkrimit të raportit, sepse është e domosdoshme një periudhë e tillë, për të qenë korrekt dhe brenda afatit.

A keni sugjerime?

Data 13 është pushim, por kjo nuk e pengon asnjë institucion.

Administrata ka komunikuar me institucionet.

Unë besoj se nuk do të ketë problematika.

Të shikojmë nëse do të kemi kthim përgjigjeje në afat. Nëse do të kemi ndonjë situatë tjetër, do të jemi në komision dhe do ta diskutojmë. Afatet janë fleksibël, ne i vendosim. Mund edhe t'i shtyjmë afatet, në varësi të situatës. Mund të lindë nevoja për një veprim tjetër hetimor gjatë ditëve në vijim, që mund të kërkojë më tepër kohë. Ne do ta marrim parasysh, por është e rëndësishme të ruajmë afatet që na ka caktuar vendimi i Kuvendit. Nga pikëpamja ligjore, nëse është e domosdoshme, ne mund t'i kërkojmë Kuvendit shtyrjen e afatit, por mendoj se nuk do të jetë e domosdoshme një kërkesë e tillë. Pra, të mos e paragjykojmë. Të ecim me këtë kalendar dhe do ta shikojmë hap pas hapi vijimin e veprimtarisë.

Fjalën e ka zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Po shikoja kalendarin dhe data 20 është ditë e enjte, kur ne kemi seancë plenare. A mund ta shikojmë?

**Alket Hyseni** – Unë kam komunikuar me shërbimin e sallës. Nuk ka ende një datë prej tyre, por meqenëse afati i veprimtarisë tonë është i kufizuar, ne nuk do të na pengojë asgjë të vazhdojmë veprimtarinë tonë. Nëse do të kemi ditë seance, do të ushtrojmë të drejtën tonë. Kush ka për të shkuar në seancë, diskuton, voton dhe vazhdon me veprimtarinë, nëse do të ketë. Kjo është detyra jonë primare në këtë moment, të cilën na e ka ngarkuar Kuvendi, dhe mendoj që prevalon mbi çdo tjetër. Megjithatë, asnjë nga datat nuk është e padiskutueshme në mbledhjet e ardhshme dhe do t'i shikojmë.

Hedhim në votim kalendarin.

Kush është dakord me draftkalendarin? Të gjithë janë pro.

Miratohet.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: caktimi e ekspertëve për marrjen e ekspertizës.

Në këtë pikë do të presim propozime.

Në gjykimin tim dhe të sekretares, me të cilën kemi diskutuar, por edhe në konsultë me nënkryetarin, kemi menduar se do të na duhen 2 ekspertë konstitucionalistë, njohës të mirë të Kushtetutës shqiptare, të jurisprudencës së Gjykatës sonë Kushtetuese, të jurisprudencës së Komisionit të Venecies dhe të Gjykatës Europiane, por edhe të gjykatave të tjera.

Do të preferonim të ishin njohës të jurisprudencës amerikane, sepse kanë kazuse të ngjashme dhe të freskëta, të cilat mund të na orientojnë edhe në këtë hetim, sikurse ishte rasti i *implacement* për Presidentin Trump, ndaj presim propozime emrash.

Fjalën e ka zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Nisur nga eksperiencat që kemi pasur në Kuvend me ekspertë konstitucionalistë, unë do të propozoja zotin Erind Mërkuri, i cili ka qenë edhe në procedurën parlamentare të ndryshimeve kushtetuese. Mendoj se ka një CV-i që i përgjigjet nevojës së komisionit. Propozoj të jetë një nga ekspertët.

**Alket Hyseni** – A ka propozime të tjera?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë kam një pyetje.

Për sa i përket numrit të ekspertëve, mendoni se është i mjaftueshëm një, apo duhen dy? Nëse do të jenë dy, jam dakord për Erindin.

**Alket Hyseni** – Unë thashë se ne kemi diskutuar për dy ekspertë konstitucionalistë.

**Vasilika Hysi** – Unë jam dakord për Erindin.

Për momentin, nuk kam propozim tjetër.

**Spartak Braho** – Ju lutem, mund të na thoni cilët janë, ku punojnë dhe a kanë tituj? Janë nga rruga, apo ...

**Alket Hyseni** – Po, zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Zoti Braho ka të drejtë.

Ne duhet të kishim një dosje për ekspertët, por shërbimet e sekretarisë e kanë dosjen e ekspertit, sepse, siç ju thashë, ka punuar me ne në ndryshimet kushtetuese të korrikut 2020 për çështjet zgjedhore. Sekretaria mund t'i pajisë të gjithë anëtarët e komisionit me CV-në e zotit Mërkuri.

Nga ana tjetër, mund të kemi dy ekspertë. Unë nuk e çmoj të arsyeshme të kemi më shumë se një, por nëse e çmoni të jenë dy ekspertë, të japin sugjerime të gjithë kolegët.

**Alket Hyseni** – Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

E quaj të drejtë kërkesën e zotit Braho.

Unë dua të them dy fjalë për ekspertin.

Erind Mërkuri është pedagog i të Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, me gradë shkencore “Doktor” dhe ka një aktivitet të gjerë në fushën e të drejtës kushtetuese.

Gjithashtu, është njohës shumë i mirë i praktikës së Gjykatës Kushtetuese shqiptare, i Gjykatës së Strasburgut dhe, njëkohësisht, edhe i praktikës së Komisionit të Venecies.

Sikurse e tha edhe kolegja Bushka, është angazhuar nga Kuvendi i Shqipërisë herëherës në çështje, që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë ose me aspekte të ndryshimit të Kushtetutës. Gjithashtu, ka një veprimtari shumë të zgjeruar kërkimore dhe shkencore në këtë fushë. Pra, është pedagog në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Braho, një sekondë.

Do të thosha se edhe unë e njoh ekspertin dhe punën e tij. Ai ka qenë i angazhuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe besoj se është i denjë për të qenë ekspert i këtij komisioni, por megjithatë, nëse keni propozime apo diskutime të tjera, i presim.

Ndërkohë, sekretaria duhet t’u shpërndajë CV-në e ekspertit anëtarëve të komisionit.

Po, zoti Murrizi.

**Myslim Murrizi** – Para se ta propozojmë, a e keni pyetur këtë person? Ka rënë dakord të vijë, apo jo? A ka konflikt interesi?

**Alket Hyseni** – Ne do ta caktojmë sot dhe ai do të thërritet për t’i caktuar detyrat në mbledhjen tjetër.

Nëse do të ketë rrethana të papajtueshmërisë, do të paraqiten, dhe ai do të deklarojë nëse pranon ose jo. Ne sot do të bëjmë caktimin. Nuk mund t’i paragjykojmë personat paraprakisht.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në dijeninë tonë nuk ka.

Megjithatë, do të jetë e deklaruar.

Sikurse e kemi thënë në fillim të konstituimit, siç është edhe në Rregullore, ne jemi të detyruar të respektojmë disa rregulla procedurale strikte të Kodit të Procedurës për rastet

konkrete. Kodi parashikon të caktohet eksperti, të thirret dhe të deklarojë nëse ka shkaqe papajtueshmërie, të deklarojë nëse e pranon detyrën dhe pastaj i jepen detyrat nga komisioni.

Në këto rrethana, nuk mund të paragjykojmë asnjë emër, ndaj jeni të mirëpritur të bëni propozime për emra të tjerë. Rëndësi ka të jetë i denjë për këtë detyrë, të ketë njohuritë e duhura, eksperiencën e duhur për të na mundësuar ne një ekspozë më të gjerë të jurisprudencës së gjykatave të ndryshme dhe të qëndrimeve të ndryshme. Mund të kemi nevojë t'i bëjmë pyetje konkrete për ato për të cilat Kushtetuta nuk është eksplicite, sikurse është togfjalëshi “shkelje të rënda të Kushtetutës”, për të ditur çfarë mund të konsiderohet nga ana jonë shkelje e rëndë kushtetuese dhe çfarë mund të jetë një shkelje që nuk klasifikohet e tillë, në mënyrë që në raportin tonë të jemi të qartë dhe t'i bëjmë një ekspozë të qartë Kuvendit, i cili është organi përfundimtar, që do të vijojë me këtë procedurë, por do të bazohet në raportin tonë. Ne aty duhet të jemi të saktë, për t'i thënë nëse kemi apo jo shkelje të rënda të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës apo nëse gjatë hetimit dalin rrethana të tjera, që mund të jenë elementet e dyta të parashikuara në Kushtetutë, rrethanat e një krimi të rëndë. Prandaj është e nevojshme të kemi ekspertët.

Nëse do të jenë një apo dy ekspertë, ne e diskutuam një herë, zonja Bushka. Thamë të jenë dy ekspertë, sepse përherë është më mirë, por këtu jemi dhe vendimin e merr komisioni.

Po, zonja Xhina.

Zoti Braho, më falni, keni fjalën menjëherë pas zonjës Xhina!

**Elena Xhina** – Shumë mirë që do të flasë dhe zoti Braho.

Në fakt, unë mendoj se duhet të jenë 2 ekspertë. Jam shumë dakord me ekspertin që ju përmendët dhe jam e bindur se ai e kryen më së miri detyrën dhe njohuria e tij është pikërisht në fushën e posaçme ku ne kemi nevojë, por mendimet e dy ekspertëve do të ishin më të kompletuara dhe nuk do të linin vend për diskutime, nëse njëri ekspert mund të ishte i anshëm në vendimin e tij apo mund të kishte ndikime të natyrës politike, po themi, meqenëse çështja është shumë delikate.

Në këto kushte, unë do të kërkoja të ishin dy ekspertë, pasi mendoj se do të na sillnin mendime më të kompletuara, që do të ishin më të formësuara për këtë komision.

Ftoj kolegët të na njohin me ndonjë emër tjetër, që mund të jetë i vlefshëm për këtë çështje.

**Alket Hyseni** – Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** – Të nderuar kolegë,

Procedura e ekspertimit të shkeljeve që pretendohet se ka kryer Presidenti është momenti më i rëndësishëm i këtij komisioni hetimor. Të mos nxitohemi! Pjesa dërrmuese e



krahut këtej, se e njoh më mirë, e di se çfarë do të thotë një ekspertizë e mirë apo një ekspertizë e keqe. Një ekspertizë e mirë të hedh matanë; një ekspertizë e keqe të “varros”.

Në të njëjtën kohë, në fund të fundit, ky komision gjykon nëse Presidenti e ka shkelur apo nuk e ka shkelur rëndë Kushtetutën. Kjo do të thotë që ne të përballemi me interpretimin e Kushtetutës, me interpretimin e shumë akteve të tjera të Gjykatës Kushtetuese, me interpretimin e të gjitha vendimeve të Komisionit të Venecias, dhe interpretimi i saktë i tyre nga ekspertët, si të thuash, është përfundimi i punës së komisionit tonë. Ne nuk kemi çfarë të bëjmë tjetër, do të dëgjojmë ekspertët dhe do të ngremë dorën, nëse na bindin apo jo. Prandaj ekspertët duhet të jenë njerëz me autoritet të lartë profesional, se po gjykojnë Presidentin. Nuk kam vërejtje për shokët, se nuk i njoh, për të thënë të vërtetën. Ata janë djem të rinj. Unë jam i kohës kur thërrisim si ekspert në komisione Luan Omarin, por ky i fundit është plakur tani. Kështu që mendoj se si ekspertë, përveç emrit të zotërisë që u përmend, që arrin deri te doktori, neve na duhen profesorë me tituj këtu. Megjithatë kjo është në çmimin e shokëve, që i relatojnë dhe i njohin.

Unë them: pse të mos jetë edhe Viktor Gumi ekspert? Unë do ta propozoja. Nuk e kam marrë mendimin e tij, ka të drejtë Myslimi, se ai mund të thotë edhe jo, por duke njohur nga afër vlerësimin dhe cilësitë e tij, gjykoj se ka një lloj paanshmërie. Megjithatë, ta mendojmë. Them të mos e vendosim sot çështjen e emrave të ekspertëve. T’i shohim emrat, pra të kemi një listë me disa emra, të lexojmë biografinë profesionale të tyre dhe më pas të votojmë ditën e premtë.

**Alket Hyseni** – Edhe mua më duket interesant propozimi.

Në fakt, që në mbledhjen e kaluar i thashë sekretarisë që duhet të mendojë për një listë dhe të na i vendosë në dispozicion, por nuk e ka bërë. Kështu që i tërheq vëmendjen sekretarisë teknike. Është detyrë e Kuvendit për t’i paraqitur këtij komisioni një listë të ekspertëve të kësaj fushe. Sekretaria, ju lutem, mbajeni shënim dhe herën tjetër, para mbledhjes, do t’u bëni me dije anëtarëve të komisionit një listë ekspertësh dhe do ta diskutojmë, të paktën ne, të kryesisë së komisionit, nënkryetari, zoti Murrizi, dhe zonja Bushka, në mënyrë që, kur të vijmë këtu, të vijmë me një orientim dhe për anëtarët e tjerë, të kemi bërë një shohitje paraprake të kandidaturave, për të sjellë këtu ekspertizën më të mirë të mundshme, pa paragjykuar punën e kujtdo eksperti, sepse janë shumë emra të mundshëm për të qenë ekspertë, por neve do të na duhen dy ekspertë, të cilët do të jenë dhe hulumtues, njohës shumë të mirë të praktikave të gjykatave të huaja kushtetuese dhe të paanshëm në profilin e tyre. Të mundohemi të gjejmë maksimumin e paanshësisë.

Atëherë, do të hedh në votim propozimin e zotit Braho për të shtyrë miratimin apo caktimin e ekspertëve në mbledhjen e datës 14 maj. A jeni dakord me këtë propozim? Ju lutem, ngrini duart! Të gjithë janë dakord.

Atëherë, caktimi i ekspertëve shtyhet për seancën tjetër.

Urdhëroni, zoti Braho! Çfarë kishit?

**Spartak Braho** – Meqenëse jemi tek ekspertët, bazuar dhe në materialin paraprak që kemi, pjesa dërrmuese e akuzave ndaj Presidentit janë të pasqyruar në materiale filmike, të shfaqura në kronikat e ndryshme televizive, në prononcimet e tij dhe në mediet e shkruara. Do të kërkoja që këto materiale të transkriptonen. Nuk shkon. Unë jam marrë me të tilla ekspertime. Thuhet: “Ka pretendime për manipulime, në audio, në video”, por ne duhet t’i kemi të transkriptuara, sepse është edhe më serioze për komisionin. Këto materiale transkriptonen për jo më shumë se 3-4 orë. Në këtë fushë ne kemi ekspertë shumë të mirë. Nuk e shtroj si detyrim këtë, por si mendim. Në qoftë se e pranoni këtë logjikë, unë mund t’ju ofroj edhe ekspertin apo grupin e ekspertëve për këtë çështje.

**Alket Hyseni** – A ka ndonjë mendim tjetër për çështjen?

Megjithëse ne e shtymë si pikë dhe do ta diskutojmë herën tjetër, çdo anëtar është i lirë edhe të sjellë propozime, pra gjatë këtyre 2-3 ditëve ju mund të mendoni emra të caktuar. Nëse do të vijmë në një nivel ekspertize të tillë, sikurse propozon zoti Braho, do ta diskutojmë, por pavarësisht se ne jemi në rolin e një *quazi* gjykate, në kuptimin e ekspertizës, mendoj se duke i marrë materialet nga institucionet, nga AMA, e kemi të certifikuar sa i takon procedimit parlamentar. Nëse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jam i qartë. Unë e çmoj dhe eksperiencën dhe...

*(Zoti Braho ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Braho, unë jam dakord me ju dhe e di që në të kaluarën ka goxha praktikë ku për shkak të hapësirave procedurale ka pasur shmangie nga hetimet, përfitime të mëdha apo ikje nga e vërteta, por do ta diskutojmë, unë nuk e përjashtova. Unë po diskutoj në sensin që deri ku shkon një komision hetimor. Kjo është për t’u diskutuar. A shkojmë ne deri në një ekspertizë teknike? E para, nuk kemi kontestim nga personat që janë në procedim. Nëse do të ketë pretendime të tilla, patjetër që do të diskutohet, por edhe pa pretendime të tilla ne këtu jemi dhe do ta diskutojmë kur të kemi rendin e ditës.

Unë do të doja nga anëtarët e komisionit që, deri në mbledhjen e ardhshme, pasi Sekretariati Teknik të na vendosë dhe një listë në dispozicion, të jemi në gjendje të propozojmë emra konkretë. Biem dakord që do t’i caktojmë ekspertët konstitucionalistë në seancën tjetër.

Nëse do të kemi nevojë të diskutojmë përsëri për një ekspertizë të një fushe tjetër, do ta diskutojmë në mbledhjen tjetër.

A mund ta quajmë të...?

Urdhëro, zoti Murrizi!

**Myslim Murrizi** – Duke vazhduar logjikën e kërkesës, sipas meje të drejtë, të zotit Braho, do të doja nga stafi të kontaktojë me rektorin e universitetit apo me dekanin e fakultetit juridik, por edhe me personat konkretë (Mërkuri u propozua), me Viktorin apo me dikë tjetër. Ne nuk kemi përse ta miratojmë formalisht dhe ai të vijë këtu e të na thotë që nuk dua. Pra, duhet të kontaktohet paraprakisht, që komisioni hetimor i Kuvendit ka në agjendën e tij apo ka një mendje që ti të jesh ekspert i këtij komisioni dhe a pranon apo nuk pranon. Ne nuk kemi përse ta shtyjmë prapë të premtën dhe ai të vijë këtu e të thotë: “Ju faleminderit për respektin, por unë nuk pranoj të jem, se kam *x* arsye”. Pra, nga stafi apo nga vetë kryetari i komisionit ose sekretarja le të dërgohet një shkresë dhe të kontaktohet zyrtarisht me rektorin e universitetit, meqenëse duhet nga pjesa akademike, por edhe me juristët e spikatur, ndoshta me zotin Gumi apo me dikë tjetër nga avokatia, që ka pasur jo pak çështje në Gjykatën Kushtetuese.

Sa për kasetat filmike, unë do të isha i rezervuar, në sensin që u besoj më shumë informacioneve zyrtare të institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese (këtu kam parasysh Shërbimin Informativ, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë Speciale, SPAK-un).

Për daljet publike të Presidentit të Republikës, për daljet *live* përballë gazetarëve (dy raste, me sa kam parë në material), gjithsecili është i lirë të thotë që e kam bërë për gallatë, por unë nuk besoj se aty ka ndërhyrje, sepse ka qenë emision *live*, i drejtpërdrejtë, përpos lajmeve të ndryshme të ardhura pa deklaruar vetë Presidenti i Republikës diçka publike. Pra, unë nuk besoj se merret për bazë në komisionin hetimor se shkruan një portal, një media e shkruar apo një *live* në një media audiovizive që Presidenti ka takuar 4 kontigjentë në Tepelenë apo poshtë urës së Rrogozhinës. Ne nuk kemi pse të merremi me këtë. Informacionet zyrtare të agjencisë ligjzbatuese, që mbikëqyr personalitete të larta të këtij vendi, nëse kanë kontakte me elementë të botës së krimit, nëse kanë kontakte me elementë të cilët janë të skeduar nga shërbimet përkatëse si elementë antishqiptarë apo ku ta di unë, të llumhanes së kësaj shoqërie, për mua janë fakte dhe nuk kam nevojë të pyes më tjetërkënd nëse ma dërgojnë informacionin institucionet ligjzbatuese të këtij vendi. Prandaj kam kërkuar herën e parë që t’i dërgohet një kërkesë qoftë Shërbimit Informativ, qoftë dhe shërbimeve të tjera, se nuk është vetëm Shërbimi Informativ, gjatë gjithë aktivitetit presidencial, ndoshta që nga janari, shkurti, marsi e prilli, pra flasim për këtë muaj, kur kanë qenë më të intensifikuara takimet e tij elektorale dhe daljet publike.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëro!

Ata mund të thonë nuk që nuk ka gjë, por neve nuk na pengon asnjë gjë t'ia përcjellim shkresën dhe prokurorisë, e cila pas nesh do të hetojë nëse ka apo nuk ka shkelje. Për shembull, po marr një rast, një takim i aluduar në Vlorë...

**Alket Hyseni** – Zoti Murrizi, të mos paragjykojmë! Institucionet do të...

Zoti Braho, të lutem!

Se çfarë do të thonë institucionet, atë e dinë ato. Në varësi të asaj çfarë thonë ato, ne do të marrin vendimet. Ju lutem, të mos hyjmë këtu!

Ne nuk jemi gjykatë penale, të mos e ngatërrojmë gjënë, por jemi komision hetimor parlamentar dhe e shqyrtojmë veprimtarinë duke u bazuar dhe në Kodin e Procedurës Penale. Ne nuk bëjmë ekspertizat e kasetave këtu. Ekspertizat, ata që kanë mësuar t'i bëjnë, le t'i bëjnë kur të vijë koha dhe t'i shmangen drejtësisë. Ne këtu kemi rënë dakord bashkë që do t'i drejtohem AMA-s. Do të na e sjellë informacionin AMA dhe do ta marrim të mirëqenë,. Të mos hyjmë në debat kot tani! Ju lutem, ta mbyllim këtë temë!

E mbyllim këtë pikë të rendit të ditës.

Jemi te çështjet e tjera.

A ka dikush tjetër për të shtuar diçka te çështjet e tjera? Nuk ka.

Atëherë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Urdhëroni, zoti Braho, por sapo e thashë!

Të lutem, shtype mikrofonin kur të flasësh, që të...

**Spartak Braho** – Është shpërndarë një material fillimisht, por unë dje pata kohë dhe e lexova (ky që shoqërohet me firmat e deputetëve). Në kapitullin III, “Shkeljet e rënda kushtetuese”, nuk e di se kush është marrë me formulimin, thuhet: “Presidenti i Republikës është kreu i shtetit shqiptar, garant i Kushtetutës dhe përfaqësuesi i unitetit kombëtar”. Ku e kanë gjetur këtë?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Cila kërkesë...?

**Alket Hyseni** – Zoti Braho, ajo është një kërkesë e 49 deputetëve. Ata e kanë formuluar siç e kanë gjykuar.

Të lutem, shtype mikrofonin, se nuk regjistrohet!

Pra, kërkesa është ashtu siç e kanë menduar 49 deputetët. Ata e kanë formuluar ashtu, gjykojnë se jemi para atyre rrethanave, gjykojnë se jemi para atyre shkeljeve dhe tashmë

kërkesa ka ardhur në këtë komision me një ekspertizë më të lartë, që do të vendosë nëse në raportin e tij do t'i thotë Kuvendit nëse kemi apo nuk kemi të bëjmë me shkeljet e pretenduara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Spartak Braho** - Nuk e kam aty, por ti nuk po më ndjek. Unë dhe ti e kemi firmosur këtë kërkesë. Dakord? Ku është gjetur kjo: “Presidenti është garant i Kushtetutës”?! Është turp! Se Ilir Meta ka 3 muaj që e përdor këtë: “Unë jam garant”, ndërkohë që nuk është garant.

**Alket Hyseni** – Jam i qartë, zoti Braho, por këtë pyetje mund t’ia kishit bërë dhe vetes para se të firmosnit. Nuk ka rëndësi, kjo është në kuptimin e figurshëm, është në kuptimin e unitetit të popullit, dhe personi që është garant i unitetit të popullit, siç e thotë Kushtetuta, kur bën dhe betimin...

**Spartak Braho** – Jo, nuk e thotë ashtu...

**Alket Hyseni** – Të lutem, a mund ta jap shpjegimin? Të lutem, mbylle mikrofonin!

*(Zoti Braho ndërhyn pa mikrofon)*

Për kërkesën, pra.

*(Zoti Braho ndërhyn pa mikrofon)*

Zoti Braho, të lutem, të flasim me radhë! A doni të vazhdoni ju dhe ta marr më pas fjalën?

Në formulën e betimit të Presidentit të Republikës, zoti Braho, përcaktohet se Presidenti i Republikës i përmbahet vetëm Kushtetutës dhe, në këtë aspekt, është në kuptimin e figurshëm. Të mos i hyjmë kësaj! Nuk ka asnjë gjë. Kjo nuk është “çështje të tjera”. Mendoj se ky është një koment personal dhe mbajeni për vete.

*(Zoti Braho ndërhyn pa mikrofon)*

Zonja Xhina, të lutem!

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do t’i rikthehem diskutimit që bëri zoti Braho herën tjetër. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm me interpretimet dhe diskutimet që bëjmë në këtë komision. Ne kemi një rend dite dhe duhet t’i përmbahemi rendit të ditës. Këto diskutime më duken pavend, duke filluar nga zoti Murrizi, se çfarë do të bëjë agjencia dhe çfarë përgjigjesh do të na vijjë. Kur të na vijjë, do t’i interpretojmë. Ju lutem, përmbajuni rendit të ditës! T’i lëmë diskutimet e tepërta, sepse kemi dhe komisione të tjera dhe duhet të lëvizim.

Kështu që mendoj t’i hedhim në votim ato që nuk i kemi hedhur dhe...

**Alket Hyseni** – Nuk kemi gjë për të hedhur në votim.

Ju falënderoj për praninë tuaj sot!

Mbledhja e ardhshme do t'ju njoftohet proceduralisht nga sekretariati dhe administrata e Kuvendit, por, sikurse ramë dakord paraprakisht, do të jetë në datën 14.

Ditë të mbarë!

Gjithë të mirat!

## **MBYLLET MBLEDHJA**